VENDIM
Nr.19, datë 11.1.1993

PËR FONDIN E VEÇANTË NË INSTITUCIONET BUXHETORE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në institucionet buxhetore krijohet fondi i veçantë që përdoret nga drejtuesit e këtyre institucioneve për të shpërblyer punonjësit për punë cilësore, për nevoja kulturore dhe për dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësisht dhe raste të tjera të kësaj natyre.

2. Në ministritë dhe institucionet e tjera qëndrore fondi i veçantë krijohet në masën 5 për qind mbi fondin e planifikuar të pagave.

3. Në këshillat e rretheve, në bashki, komuna, institucione, njësitë e repartet ushtarake dhe në ndërmarrjet buxhetore fondi i veçantë krijohet në masën 5 për qind mbi fondin e planifikuar të pagave. Masa e shpërblimit për çdo punonjës të mos jetë më shumë se 20 për qind të pagës bazë vjetore dhe të shtesave mbi pagë të punonjësit.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 4.1.1992 “Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV. KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku